Hyrje: Hapja e sutures midpalatinale tek moshat adulte paraqet sfidë në vete si në fushën e ortodoncisë ashtu dhe të kirurgjisë ortognatike. Deri vonë si opsion i vetëm për hapjen e suturës palatinale dhe zgjerimin transversal të maksilës, në moshat adulte ka qenë përmes metodës SARPE (surgically-assisted rapid palatal expansion). Viteve të fundit ka gjetë zbatim edhe një metodë e re, metoda MARPE (miniscrew -assisted rapid palatal expansion). **Qëllimi:** i këtij prezantimi është që të tregohen përparësitë, procedura dhe rezultati me metoden MARPE te rasti klinik. **Materiale dhe metoda:** Pacientja A.G. moshë 22 vjeçe e diagnostifikuar me malokluzion skeletorë të kl III, diskrepancë sagjitale dhe transversale e maksillës ndaj mandibulës, profil konkav, korridore bucale, kafshim të kryqezuar anterior dhe posterior, dendësi dentare. Duke u nisur nga diagnoza janë dhënë opsionet e mundshme të trajtimit. Trajtimi u realizua me metodën MARPE, si metodë joinvazive dhe me aparatën fikse ortodontike. Nga imazhet radiologjike 3D dhe skanimit intraoral është përcaktuar trashësia e kockës dhe në modelët digjitale janë përcaktuar lokuset ku do inserohen minividat. Me ndihmën e guides orientuese inserohen 4 minividat në palatum. Merret serish masa e modeleve me skan body dhe punohen ekspanderat bone borne. **Rezultati:** Me aktivizimin e vazhdueshëm të vidës së ekspanderit, sipas protokollit u arrit hapja e suturës midpalatinale dhe zgjerimi i dëshiruar i maksillës, korrektura e kafshimit të kryqezuar antero posterior, përmirësimi i korridoreve bucale, buzeqeshja dhe profili. **Përfundimi:** Ky rast i prezantuar demonstroi trajtimin e suksesshëm me MARPE, si një metodë më pak invazive krahasuar me SARPE, shmang nevojën e një ndërhyrje kirurgjike dhe ofron korrigjim funksional dhe estetik dentofacial. **Fjalët kyçe:** MARPE, SARPE, kl. III, 3D.

Ndikimi i Gëlltitjes Atipike në Deformimin e Mandibulës – Prezantim rasti

Ariana Shoshi^{1,2}, Blerim Mehmeti^{1,3}, Ylli Shoshi²

¹ Qendra Klinike Stomatologjike Universitare e Kosovës, Klinika e Ortodoncisë; ² AMECC "Rezonanca"

¹ Klinika e Ortodoncisë, Qendra Klinike Stomatologjike Universitare e Kosovës; ³ Kolegji AAB, Prishtinë, Kosovë

² Klinika e Kirurgjisë Maksillofaciale, Qendra Klinike Universitare e Kosovës

Hyrje: Gëlltitja atipike është një çrregullim funksional orofacial që karakterizohet nga një model jonormal i lëvizjes së gjuhës gjatë gëlltitjes i cili nëse nuk trajtohet në kohë,

MARPE- Case presentation

Diturije Bytyqi¹, Agron Bytyqi²

^{1,2} Private clinic, Prishtina, Kosovo

Introduction: Opening the midpalatal suture in adults represents a challenge in itself both in the field of orthodontics and orthognathic surgery. Until recently, the only option for opening the palatal suture and transverse expansion of the maxilla in adults was through the SARPE method (surgically-assisted rapid palatal expansion). In recent years, a new method has also been applied, the MARPE method (miniscrew-assisted rapid palatal expansion). **The purpose** of this presentation is to show the advantages, procedure and result of the MARPE method in a clinical case. **Materials and methods:** Patient A.G., 22 years old, diagnosed with skeletal malocclusion class III, sagittal and transverse discrepancy of the maxilla to the mandible, concave profile, buccal corridors, anterior and posterior crossbite, and dental density. Starting from the diagnosis, possible treatment options were given. The treatment was performed with the MARPE method, as a non-invasive method and with fixed orthodontic appliances. From the 3D radiological images and intraoral scanning, the bone thickness was determined, and in the digital models, the loci where the miniscrews will be inserted were determined. With the help of the orientation guide, the 4 miniscrews are inserted into the palate. The models are measured again with a body scan, and the bone-borne expanders are worked. **Result:** With continuous activation of the expander screw, according to the protocol, the midpalatal suture opening and the desired maxillary expansion were achieved, the anteroposterior crossbite was corrected, the buccal corridors were improved, and the smile and the profile were improved. **Conclusion:** This presented case demonstrates successful treatment with MARPE, as a less invasive method compared to SARPE, avoiding the need for surgical intervention and providing functional and aesthetic dento-facial correction. **Keywords:** MARPE, SARPE, class III, 3D.

The Impact of Atypical Swallowing on Mandibular Deformity – Case Presentation

Ariana Shoshi^{1,2}, Blerim Mehmeti^{1,3}, Ylli Shoshi²

¹ University Clinical Dental Centre of Kosovo, Clinic of Orthodontics;

² AMECC "Rezonanca"

¹ Clinic of Orthodontics, University Clinical Dental Centre of Kosovo;

³ AAB College

² Clinic of Maxillofacial Surgery, University Clinical Centre of Kosovo

Introduction: Atypical swallowing is a functional orofacial disorder characterised by an abnormal pattern of tongue movement during swallowing, which, if not treat-

ndikon negativisht në zhvillimin kraniofacial, veçanërisht në regionin e nofullave. *Qëllimi* i punimit ishte të prezantoj një rast klinik ku gëlltitja atipike ka rezultuar në deformim mandibular, si dhe të theksojë rëndësinë e diagnozës së hershme dhe trajtimit multidisiplinar për parandalimin e komplikimeve funksionale dhe estetike. *Materiali dhe metodologjia*: Ky është prezantim i një rasti klinik, pacient i moshës 12 vjeç, i cili është paraqitur me vështirësi në përtypje, vështirësi në të folur dhe frymëmarrje si dhe shqetësime estetike. Pas ekzaminimit klinik kemi arritur tek diagnoza përfundimtare, gëlltitje atipike persistente. Trajtimi ka përfshirë vendosjen e aparatit ortodontik për korrigjimin e kafshimit të hapur posteriore dhe devijimit të vijës së mesit, terapi miofunksionale për riedukimin e modelit të gëlltitjes, ushtrime për forcimin e muskujve orofacialë, pozicionimin e gjuhës dhe përmirësimin e frymëmarrjes nazale si dhe vlerësim për ndërhyrje të mundshme kirurgjikale në raste të avancuara. *Rezultatet*: Trajtimi ka rezultuar në përmirësim në mbylljen e kafshimit, modelin e gëlltitjes, tonusin e gjuhës dhe muskujve orofacialë që në fillim të muajit të dytë. Pacienti ende është në trajtim. *Përfundimi*: Si përfundim konkludojmë se tek rastet me gëlltitje atipike diagnoza dhe ndërhyrja e hershme janë thelbësore për të parandaluar pasojat më të rënda. *Fjalët kyçe*: Gëlltitje atipike, deformim mandibular, terapi miofunksionale, ortodonci, trajtim multidisiplinar.

Karakterizimi akustik i tingullit Sh - /ʃ/ te pacienti ortodontik permes analizes spektrografike – prezantim rasti

Rina Caka¹, Korab Shaqiri², Armend Xhoni³, Egin Hoxha⁴, Blerim Mehmeti^{5,3}

¹ Klinikë private, Prishtinë, Kosovë

² Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", Prishtinë, Kosovë

³ Kolegji AAB, Prishtinë, Kosovë

⁴ Klinikë private, Kosovë

⁵ Klinika e Ortodoncise, Qendra Klinike Stomatologjike Universitare e Kosovës; 3 Kolegji AAB, Prishtinë, Kosovë

Hyrje: Aparatet ortodontike mobile janë pajisje terapeutike, kur aplikohen në dhëmbë dhe nofulla, ndihmojnë në korrigjimin e anomalive dentoalveolare që nga mosha 7-vjeçare. Këto aparate kanë përdorim të gjerë në ortodoncinë pediatrike për shkak të efektit të tyre pozitiv në udhëheqjen e zhvillimit normal të nofullave dhe korrigjimin e malokluzioneve të lehta dhe të moderuara. Megjithatë, sipas disa studimeve të mëhershme dhe përvojave klinike, është vërejtur se trajtimi me aparate ortodontike mobile mund të shoqërohet me vështirësi në artikullimin korrekt të disa tingujve frikativë, veçanërisht gjatë javëve të para të përdorimit, kur pacienti është ende në fazën e

ed in time, negatively affects craniofacial development, especially in the jaw region. *The aim* of the paper was to present a clinical case where atypical swallowing resulted in mandibular deformity, as well as to emphasise the importance of early diagnosis and multidisciplinary treatment to prevent functional and aesthetic complications. *Material and methodology*: This is a clinical case report, a 12-year-old patient who presented with difficulty chewing, speaking and breathing, as well as aesthetic concerns. After clinical examination, we reached the final diagnosis, persistent atypical swallowing. Treatment included the placement of an orthodontic appliance to correct the posterior open bite and midline deviation, myofunctional therapy to re-educate the swallowing pattern, exercises to strengthen the orofacial muscles, tongue positioning, and improve nasal breathing, as well as assessment for possible surgical intervention in advanced cases. *Results*: The treatment resulted in improvement in bite closure, swallowing pattern, tongue and orofacial muscle tone as early as the beginning of the second month. The patient is still undergoing treatment. *Conclusion*: In conclusion, we conclude that in cases of atypical swallowing, early diagnosis and intervention are essential to prevent the most serious consequences. *Keywords*: Atypical swallowing, mandibular deformity, myofunctional therapy, orthodontics, multidisciplinary treatment.

Acoustic characterisation of the sound Sh - /ʃ/ in an orthodontic patient through spectrographic analysis – case presentation

Rina Caka¹, Korab Shaqiri², Armend Xhoni³, Egin Hoxha⁴, Blerim Mehmeti^{5,3}

¹ Private clinic, Prishtina, Kosovo

² University of Prishtina "Hasan Prishtina", Prishtina, Kosovo

³ AAB College, Prishtina, Kosovo

⁴ Private clinic, Kosovo

⁵ Orthodontics Clinic, University Clinical Dental Centre of Kosovo; 3 AAB College, Prishtina, Kosovo

Introduction: Mobile orthodontic appliances are therapeutic devices that, when applied to the teeth and jaws, help correct dentoalveolar anomalies from the age of 7. These appliances are widely used in pediatric orthodontics due to their positive effect in guiding the normal development of the jaws and correcting mild and moderate malocclusions. However, according to some previous studies and clinical experiences, it has been observed that treatment with mobile orthodontic appliances may be associated with difficulties in the correct articulation of some fricative sounds, especially during the first weeks of use, when the patient is still in the speech adaptation phase. *The aim* of

përshtatjes së të folurit. *Qëllimi* i punimit ishte vlerësimi i ndikimit të aparatit ortodontik të tipit Schwartz në artikulin akustik të tingullit frikativ /ʃ/, përmes analizës spektrografike. Për realizimin e këtij studimi është përdorur aplikacioni Oscilloscope për të regjistruar dhe analizuar shqiptimin e tingullit /ʃ/ te një paciente femër 10-vjeçare në dy mënyra: njëra duke mbajtur në gojë aparatit ortodontik Schwartz dhe tjetra pa të. *Rezultatet*: e marra në spektrogram treguan dallime të qarta në strukturën akustike të tingullit /ʃ/. Shqiptimi i përsëritur i tingullit gjatë mbajtjes së aparatit tregoi përqendrim të energjisë rreth 4 kHz dhe më pak shpërndarje në frekuencat e larta, duke sugjeruar një artikulum të ndryshuar. Në anën tjetër, spektrogrami pa aparat tregoi një shpërndarje më të gjerë dhe tipike të energjisë deri në 8 kHz. *Përfundimi*: Këto gjetje sugjerojnë se aparatet e lëvizshme ortodontike mund të ndikojnë përkohësisht në qartësinë e të folurit. *Fjalët kyçe*: tingulli /ʃ/, spektrogram, artikulum, aparat ortodontik, frikativë, ndikimi i ortodontisë.

Karakteristikat okluzale në fëmijët e moshës 3–6 vjeç në Prishtinë, Kosovë: një studim opservues

Vesel Rrustemaj^{1,2}, Sandra Anic Milosevic¹, Bleta Bahtiri Rrustemaj³

¹ Fakulteti i Mjekësisë Stomatologji, Universiteti i Zagrebit, Kroaci;

² UBT-Kolegji, Fakulteti i Stomatologjisë, Prishtinë, Kosovë

¹ Fakulteti i Mjekësisë Stomatologji, Universiteti i Zagrebit, Kroaci, Departamenti i Ortodontisë

³ Kolegji ISPE Prishtinë, Kosovë.

Qëllimi: Qëllimi i studimit ishte të vlerësoj karakteristikat okluzale të dhëmbëve të qumështit në fëmijët e moshës 3–6 vjeç në çerdhet e Prishtinës, *Materiali dhe metoda*: Është përdorur cluster teknika e mostrimit për të përzgjedhur 655 fëmijë të moshës 3–6 vjeç nga 11 çerdhe publike dhe private në Prishtinë. Në studim janë përfshirë fëmijët me harkun e plote dentare të qumështit dhe pa trajtim ortodontik të mëparshëm. Tiparet okluzale janë vlerësuar klinikisht në okluzionin qendror, raportet sagitale të molarëve të dytë dhe kanineve të qumështit, overjeti, overbite dhe kafshimi i kryqëzuar. Testi χ^2 u përdor për të testuar mundësinë e varësisë midis variablave të pyetësorit të ekzaminimit klinik gjinisë dhe moshës së fëmijëve. *Rezultatet*: Raporti më i zakonshëm ishte raporti i drejtë i molareve (Klasa I) me 57.7%, ndjekur nga distookluzioni (Klasa II) me 27.8% dhe (Klasa III) me 2.0%. Po ashtu, raporti i kaninit në Klasën I ishte mbizotëruese me (62.9%). Malokluzionet në sagitale ishin të rralla: 84.7% e fëmijëve kishin overjet normal (1–3 mm), 11.3% kishin overjet të rritur (>3 mm), Në rafshin vertikale më të shpeshta janë: kafshimi i thellë (>3 mm) u vu re në 35.7% të fëmijëve, ndërsa kafshimi i reduktuar (<1 mm) 8.9% si dhe kafshimi i hapur me 2.9%.

the work was to evaluate the impact of the Schwartz-type orthodontic appliance on the acoustic articulation of the fricative sound /ʃ/, through spectrographic analysis. For the realisation of this study, the Oscilloscope application was used to record and analyse the pronunciation of the sound /ʃ/ in a 10-year-old female patient in two ways: one while holding the Schwartz orthodontic appliance in the mouth and the other without it. *Results*: obtained in the spectrogram showed clear differences in the acoustic structure of the sound /ʃ/. Repeated pronunciation of the sound while holding the appliance showed a concentration of energy around 4 kHz and less dispersion in high frequencies, suggesting an altered articulation. On the other hand, the spectrogram without the appliance showed a broader and typical energy distribution up to 8 kHz. *Conclusion*: These findings suggest that removable orthodontic appliances may temporarily affect speech intelligibility. *Keywords*: /ʃ/ sound, spectrogram, articulation, orthodontic appliance, fricative, impact of orthodontics.

Occlusal characteristics in children aged 3–6 years in Prishtina, Kosovo: an observational study

Vesel Rrustemaj^{1,2}, Sandra Anic Milosevic¹, Bleta Bahtiri Rrustemaj³

¹ Faculty of Medicine and Dentistry, University of Zagreb, Croatia;

² UBT-College, Faculty of Dentistry, Prishtina, Kosovo

¹ Faculty of Medicine and Dentistry, University of Zagreb, Croatia, Department of Orthodontics

³ ISPE College Prishtina, Kosovo.

Objective: The study aimed to assess the occlusal characteristics of deciduous teeth in children aged 3–6 years in kindergartens in Prishtina, *Material and methods*: A cluster sampling technique was used to select 655 children aged 3–6 years from 11 public and private kindergartens in Prishtina. The study included children with a full primary dental arch and no previous orthodontic treatment. Occlusal features were clinically assessed in central occlusion, sagittal ratios of second molars and primary canines, overjet, overbite and crossbite. The χ^2 test was used to test the possibility of dependence between the variables of the clinical examination questionnaire, gender and age of the children. *Results*: The most common ratio was the straight molar ratio (Class I) with 57.7%, followed by dystoocclusion (Class II) with 27.8% and (Class III) with 2.0%. Also, the canine ratio in Class I was predominant with (62.9%). Malocclusions in the sagittal plane were rare: 84.7% of children had normal overbite (1–3 mm), 11.3% had increased overbite (>3 mm), In the vertical plane the most frequent are: deep bite (>3 mm) was observed in 35.7% of children, while reduced bite (<1 mm) 8.9% and open bite with 2.9%. *Conclusion*: These

Përfundimi: Këto gjetje do të ndihmojnë në strategjitë për përmirësimin e shëndetit oral dhe masat parandaluese në fëmijëri, veçanërisht në lidhje me karakteristikat okuzale në denticionin primar. *Fjalë kyçe:* Malokluzioni, denticioni primar, okluzioni qendror.

Korigjimi i hershëm ortodontik i kafshimit të kryqëzuar anterior- Prezantim rasti

Venera Tasholli Rushiti¹, Gëzim Rushiti²

^{1,2} Klinikë private, Kosovë

Hyrje: Studimi trajton zhvillimin historik dhe evolucionin e ortodoncisë, me një theks të veçantë në aparatet ortodontike të lëvizshme (MOA) dhe ndikimin e përparimeve teknologjike në përmirësimin e trajtimeve. *Qëllimi:* kryesor është të vlerësohet roli i inovacioneve të fundit, si sistemi Invisalign, në rritjen e efektivitetit dhe estetikës së trajtimeve ortodontike. *Materiali dhe metoda:* përfshin një rishikim të literaturës shkencore mbi historinë dhe teknologjitë në ortodonci, si dhe një analizë të tre rasteve klinike që demonstrojnë ndikimin e aparateve celulare në korigjimin e pozicionimit të dhëmbëve dhe përmirësimin e funksionit oral. *Rezultatet:* tregojnë se ortodoncia ka pësuar një evolucion të gjatë, nga mekanizmat e thjeshtë të lashtë deri te teknologjitë moderne si Invisalign, të cilat ofrojnë trajtime më estetike dhe të përshtatshme. Rastet klinike ilustronë përmirësime të dukshme në estetikën e buzëqeshjes dhe funksionin oral pas trajtimit me aparate celulare. Rasti i parë tregon korigjimin e pozicionit të dhëmbëve, i dyti thekson rëndësinë e kontrolleve të rregullta gjatë trajtimit dhe i treti tregon ndikime pozitive në estetikë dhe funksion. Angazhimi i pacientit është thelbësor për suksesin e trajtimit. Si përfundim, përdorimi i aparateve ortodontike të lëvizshme ka përmirësuar ndjeshëm cilësinë e trajtimit, duke ofruar zgjidhje efektive dhe estetike, veçanërisht për fëmijët. *Përfundimi:* përparimet teknologjike dhe kërkesa në rritje për shërbime profesionale do të vazhdojnë të formësojnë të ardhmen e ortodoncisë, duke kontribuar në përmirësimin e shëndetit oral dhe estetikës së pacientit në nivel global. *Fjalë kyçe:* aparatet ortodontike të lëvizshme (MOA), teknologji, estetike, funksion.

findings will help in strategies for improving oral health and preventive measures in childhood, especially in relation to occlusal characteristics in the primary dentition. *Keywords:* Malocclusion, primary dentition, central occlusion.

Early Orthodontic Correction of Anterior Crossbite - Case Report

Venera Tasholli Rushiti¹, Gëzim Rushiti²

^{1,2} Private Clinic, Kosovo

Introduction: The study addresses the historical development and evolution of orthodontics, with a special emphasis on removable orthodontic appliances (MOA) and the impact of technological advances in improving treatments. *Objective:* The main one is to evaluate the role of recent innovations, such as the Invisalign system, in increasing the effectiveness and aesthetics of orthodontic treatments. *Material and methods:* It includes a review of the scientific literature on the history and technologies in orthodontics, as well as an analysis of three clinical cases that demonstrate the impact of removable appliances in correcting tooth positioning and improving oral function. *Results:* It shows that orthodontics has undergone a long evolution, from simple ancient mechanisms to modern technologies such as Invisalign, which offer more aesthetic and convenient treatments. Clinical cases illustrate significant improvements in smile aesthetics and oral function after treatment with removable appliances. The first case demonstrates the correction of tooth position, the second highlights the importance of regular check-ups during treatment, and the third demonstrates positive effects on aesthetics and function. Patient engagement is essential for the success of treatment. In conclusion, the use of removable orthodontic appliances has significantly improved the quality of treatment, providing effective and aesthetic solutions, especially for children. *Conclusion:* Technological advances and the increasing demand for professional services will continue to shape the future of orthodontics, contributing to the improvement of oral health and patient aesthetics globally. *Keywords:* removable orthodontic appliances (MOA), technology, aesthetics, function.

Radiologjia stomatologjike

Dental radiology



Titulli	Radiologjia stomatologjike
Autorë	Kreshnike Dedushi Hoti, Serbeze Kabashi Mucaj, Jeton Shatri, Donika Bajrami, Pranvera Harshova Hoxhaj, Tringa Kelmendi
ISBN	978-9951-00-377-3
Botues	Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" Prishtinë, Kosovë
Madhësia	24 cm
Faqe	623
Lidhja	E butë
Viti i botimit	2024

Radiologjia Stomatologjike është një libër universitar i botuar nga një grup autorësh nga fusha e mjekësisë dhe stomatologjisë. Ky botim shërben si një burim i rëndësishëm në fushën e radiologjisë për studentët, specialistët dhe specialistët e stomatologjisë. Libri përfaqëson një përmbledhje të të dhënave bazike dhe praktike në fushën e radiologjisë stomatologjike, duke kombinuar aspektet teorike me zbatimin klinik. Ai është i strukturuar në dy pjesë kryesore. Pjesa e parë trajton radiologjinë e përgjithshme dhe urgjencat radiologjike, ndërsa pjesa e dytë i kushtohet radiologjisë speciale dhe patologjive që kanë rëndësi të veçantë për praktikën stomatologjike. Nëpërmjet një numri të madh radiografive nga praktika klinike, janë paraqitur shembuj konkretë që e rrisin vlerën didaktike dhe praktike të këtij libri. Këto ilustrime vizuale e bëjnë tekstin më të kuptueshëm dhe lehtësojnë zbatimin e njohurive teorike në praktikën e përditshme stomatologjike, si për stomatologët ashtu edhe për studentët.

Dental Radiology is a university textbook published by a group of authors from the fields of medicine and dentistry. This publication serves as an important resource in the field of radiology for students, residents and specialists in dentistry. The book represents a summary of basic and practical data in the field of dental radiology, combining theoretical aspects with clinical application. It is structured in two main parts. The first part deals with general radiology and radiological emergencies, while the second part is dedicated to special radiology and pathologies that are of particular importance for dental practice. Through a large number of radiographs from clinical practice, concrete examples are presented that increase the didactic and practical value of this book. These visual illustrations make the text more understandable and facilitate the application of theoretical knowledge in daily dental practice, both for dentists and students.

Prof. Dr. Veton Hoxha



Prof. Dr. Veton Hoxha

Prof. Veton Hoxha ka lindur në Prishtinë në vitin 1952. Studimet i mbaroi në Fakultetin e Stomatologjisë të Universitetit të Beogradit në vitin 1977. Pas diplomimit, u punësua si stomatolog në Qendrën e Kujdesit Parësor në Prishtinë, Kosovë. Në vitin 1978 ai nisi karrierën akademike në Seksionin e Stomatologjisë në kuadër të Fakultetit të Mjekësisë, ku u zgjodh asistent në lëndën Sëmundjet e dhëmbit. Prof. Hoxha vazhdoi studimet pasuniversitare në Fakultetin e Stomatologjisë të Universitetit të Beogradit, ku përfundoi provimet dhe mbrojti me sukses tezën e magjistraturës (1982). Në vitin 1983, u regjistrua në specializimin pasuniversitar në Sëmundjet e dhëmbit dhe të gojës në Fakultetin e Stomatologjisë- Sarajevë. Në vitin 1984 përfundoi dhe mbrojti me sukses disertacionin e doktoratës, në Universitetin e Sarajevës. Në vitin 1985 u zgjodh Profesor Asistent në lëndën Sëmundjet e dhëmbit në Universitetin e Prishtinës. Në vitet 1986–1988 punoi si Profesor Vizitor në Fakultetin e Stomatologjisë, Universiteti i Stambollit, Turqi. Gjatë qëndrimit në Turqi kreu kërkime shkencore në fushën e Endodoncisë dhe Parodontologjisë, ndërsa njëkohësisht, vazhdoi punën akademike duke ligjëruar në të njëjtin universitet. Në vitin 1990 u zgjodh Profesor i Asociuar, ndërsa në vitin 1998 u zgjodh Profesor i Rregullt. Në vitin 1999 u emërua Drejtor i Kklinikave të Stomatologjisë, ndërsa gjatë viteve 2000-2001 shërbeu si Drejtor ekzekutiv i QKUK-së. Nga viti 1986 deri në 2010 mbajti pozitën e Shefit të Katedrës së Sëmundjeve të dhëmbit. Aktualisht është Shef i Departamentit të Kariologjisë dhe Prorektor për shkencë në Kolegjin “Alma

Prof. Veton Hoxha was born in Prishtina in 1952. He completed his studies at the Faculty of Dentistry, University of Belgrade in 1977. After graduation, he was employed as a dentist at the Primary Care Center in Prishtina, Kosovo. In 1978, he began his academic career at the Department of Dentistry within the Faculty of Medicine, where he was appointed as an assistant in the subject of Dental Diseases. Prof. Hoxha continued his postgraduate studies at the Faculty of Dentistry, University of Belgrade, where he completed the exams and successfully defended his master's thesis (1982). In 1983, he enrolled in the postgraduate specialization in Dental and Oral Diseases at the Faculty of Dentistry - Sarajevo. In 1984, he completed and successfully defended his doctoral dissertation at the University of Sarajevo. In 1985, he was elected Assistant Professor in the subject of Dental Diseases at the University of Prishtina. In the years 1986–1988, he worked as a Visiting Professor at the Faculty of Dentistry, Istanbul University, Turkey. During his stay in Turkey, he conducted scientific research in the field of Endodontics and Periodontology, while at the same time, he continued his academic work by lecturing at the same university. In 1990, he was elected Associate Professor, and in 1998, he was elected Full Professor. In 1999, he was appointed Director of the Dental Clinics, and during the years 2000-2001, he served as Executive Director of UCKK. From 1986 to 2010, he held the position of Head of the Department of Dental Diseases. He is currently Head of the Department of Cariology and Vice-Rector for Science at the “Alma Matera-Rezonanca” College.

Matera-Rezonanca". Interesimi i veçantë i Prof. Hoxhës për shkencën bashkëkohore është shfaqur që në fillim të karrierës së tij. Ai ka ndjekur me zell zhvillimet në Stomatologji në mbarë botën përmes pjesëmarrjeve aktive dhe korrespondencave shkencore. Në punimet dhe prezantimet e tij ka përdorur modele eksperimentale në Endodonci, duke bërë krahasime me etiologjinë aktuale. Ai është aktiv në procesin mësimor dhe edukimin e gjeneratave të reja të stafit akademik. Një pjesë e rëndësishme e veprimtarisë së tij akademike lidhet edhe me botimin e teksteve universitare: Prof. Hoxha është autor i librave bazë "Sëmundjet e dhëmbit" (pjesa I dhe II), të cilët janë miratuar si tekste zyrtare për studentët e stomatologjisë në Universitetin e Prishtinës.. Si udhëheqës i Klinikës së Sëmundjeve të dhëmbit ka mentoruar dhjetë tema masteri dhe gjashtë disertacione doktorature. Deri më sot, Hoxha ka 166 punime dhe recensione shkencore të botuara në revista të ndryshme, duke zgjeruar ndikimin e tij akademik dhe duke krijuar ura bashkëpunimi me kolegë nga shumë vende. Prof. Hoxha gëzon një reputacion të lartë në botën akademike dhe profesionale, veçanërisht në kuadër të shoqatave shkencore ndërkombëtare. Ai është themelues dhe kryetar shumëvjeçar i Shoqatës së Endodontëve të Kosovës, duke dhënë një kontribut të çmuar në zhvillimin dhe afirmimin e kësaj fushe në vend. Gjithashtu, Prof. Hoxha është anëtar i Shoqatës Evropiane të Endodontëve (ESE) dhe anëtar i përhershëm i Shoqatës Turke të Stomatologjisë si dhe i Shoqatës Turke të Endodontëve (TEA). Ai është anëtar i përhershëm i Federatës Ndërkombëtare të Shoqatave të Endodontëve (IFEA) dhe anëtar i Shoqatës Ndërkombëtare për Kërkime Dentare (IADR), duke ruajtur një bashkëpunim aktiv me qarqet shkencore ndërkombëtare. Që nga viti 2014, Prof. Hoxha është Anëtar Akademik i Akademisë Evropiane të Arteve dhe Shkencave, ku përfaqëson me dinjitet shkencën dhe arsimin e lartë të Kosovës në arenën evropiane.

Prof. Hoxha's special interest in contemporary science has been evident since the beginning of his career. He has diligently followed developments in Dentistry worldwide through active participation and scientific correspondence. In his papers and presentations, he has used experimental models in Endodontics, making comparisons with the current etiology. He is active in the teaching process and the education of new generations of academic staff. An important part of his academic activity is also related to the publication of university textbooks: Prof. Hoxha is the author of the basic books "Diseases of the Tooth" (parts I and II), which have been approved as official textbooks for dentistry students at the University of Prishtina. As head of the Clinic of Dental Diseases, he has mentored ten master's theses and six doctoral dissertations. To date, Hoxha has 166 scientific papers and reviews published in various journals, expanding his academic influence and creating bridges of cooperation with colleagues from many countries. Prof. Hoxha enjoys a high reputation in the academic and professional world, especially within international scientific associations. He is the founder and long-time president of the Kosovo Endodontics Association, making a valuable contribution to the development and affirmation of this field in the country. Prof. Hoxha is also a member of the European Endodontics Association (ESE) and a permanent member of the Turkish Dental Association and the Turkish Endodontics Association (TEA). He is a permanent member of the International Federation of Endodontic Associations (IFEA) and a member of the International Association for Dental Research (IADR), maintaining active cooperation with international scientific circles. Since 2014, Prof. Hoxha has been an Academic Member of the European Academy of Arts and Sciences, where he represents Kosovo science and higher education with dignity in the European arena.

Kongrese dhe konferenca profesionale shkencore ndërkombëtare *International scientific congresses and professional conferences*

Ortodonci

American Association of Orthodontists (AAO) Annual Session

1 – 3 May, 2026 Orlando, Florida, USA
<https://annualsession.aaoinfo.org/>

European Orthodontic Society EOS Annual Congress

7 - 11 June, 2026 Dublin, Ireland
<https://congress.eoseurope.org/>

Endodoncion

ESE Autumn Meeting – European Society of Endodontology

23-24 Oct 2026, Vilnius, Lithuania
<https://www.e-s-e.eu/for-professionals/events/>

FDI World Dental Congress

4-7 Sept 2026, Prague, Czech Republic
<https://2026.world-dental-congress.org>

35th Euro Dentistry Congress

16-17 June, 2026, Paris, France
<https://eurodentistry.dentalcongress.com/>

Cons EURO 2026 – Excellence-in-conservative dentistry- exploring-the-future

7–9 May, 2026, Bologna, Italy
<https://accademiaitalianadiconservativa.it/en/events/aicconseuro-2026-excellence-in-conservative-dentistry-exploring-the-future/>

Protetika Stomatologjike

97th American Prosthodontic Society Annual Meeting

February 19-20, 2026, Chicago, IL, USA
https://www.prostho.org/annual_meeting/

FDI World Dental Congress

4-7 Sept 2026, Prague, Czech Republic
<https://2026.world-dental-congress.org>

The 49th European Prosthodontic Association (EPA) Conference

1 -3 Oct, 2026, Prague, Czech Republic
<https://www.epadental.org/conferences/conferences>

Kirurgji orale

Takimi i 7-të Ballkanik i Kirurgjisë Orale dhe Maxillofa- ciale

17–18 Prill 2026, Tiranë, Shqipëri
<https://www.eacmfs.org/event/7th-balkan-meeting-of-oral-and-maxillofacial-surgery/>

Takimi Vjetor Shkencor 2026 i Asociacionit Britanez i Kirurgëve Oralë dhe Maxillofacialë,

24–26 Qershor 2026, Belfast, Mbretëria e Bashkuar
https://www.baoms.org.uk/professionals/events_and_courses/date/2026/

Kongresi Evropian I Oseointegritimit

24-26 Shtator 2025, Lisbon, Portugali
<https://eao.org/congress/>

Takimi i 108-të i Asociacionit American të Kirurgjisë Orale dhe Maxillofaciale

28 Shtator – 3 Tetor 2026, Seattle, SHBA
<https://aaoms.org/education-meetings/meetings/2026-annual-meeting>

European Congress of Osseointegration

24-26 Shtator 2026-Lisbon Portugali
<https://eao.org/congress/>

Pedodonci dhe Stomatologji Preventive

18th Congress of The European Academy of Pediatric Dentistry EAPD

1-4 July 2026, Liverpool UK
<https://www.eapdcongress.com/>

4th IAPD International Association of Pediatric Dentistry, Global Summit

13-15 November 2026 Barcelona Spain
<https://iapdworld.org/>

American Academy of Pediatric Dentistry (AAPD) Annual Session

May 21–24, 2026, : Las Vegas, Nevada, USA
<https://www.aapd.org/education/aapd-2026/>

Smart Pedodontics Conference Next level in Pedodontics

9-11 October 2026 Timisoara, Romania
<https://smartpedo.com/>

Paradontologji dhe Mjekësi Orale

Perio Days (Czech Society)

May 15–16, 2026, : Czech Republic
https://www.efp.org/news-events/upcoming-events-from-efps-member-societies/article/?tx_llcat-alog_pi%5Bnews%5D=31180&cHash=df6f682cf853cb-6904c114a848502272

American Academy of Periodontology (AAP) Annual Meeting

Oct 29–Nov 1, 2026, Seattle, USA
<https://www.perio.org/ce-meetings/future-aap-annual-meetings/>

Revista e Stomatologëve të Kosovës publikohet dy herë në vit. Punimet dërgohen në mënyrë elektronike në adresën: revista@osk-ks.org

Kategoria e punimeve:

- Punim kërkimor-shkencor
- Punim revial
- Përshkrim rasti
- Vështrim profesional

Po ashtu, mirëpresim edhe shkrime informative për çështje specifike me interes të përgjithshëm në sektorin e stomatologjisë, si: kumtesa të shkurta, përmbledhje nga konferencat shkencore si dhe vështrime editoriale dhe të ngjajshme.

Pregatitja e punimit

Autori i punimit dhe koautorët duhet të garantojnë me nënshkrim të tyre në formular, që punimi është origjinal dhe i pa publikuar edhe në ndonjë revistë tjetër.

Punimi duhet të jetë i shkruar në gjuhën shqipe, në Times New Roman me madhësi 12.

Numri i faqeve duhet të jetë jo më shumë se 6 (gjashtë), duke përfshirë këtu tekstin dhe tabelat në Word si dhe fotografitë në JPEG format.

Punimet shkencore dhe profesionale duhet të përmbajnë: letër hyrëse, abstraktin, hyrjen, materialin me metodologjinë, rezultatet, diskutimin, konkluzat dhe literaturën. Kategoritë tjera formatohen në mënyra të ndryshme.

Letra hyrëse - përfshinë titullin e punimit, emrat e autorëve, kualifikimet e tyre, institucioni publik/privat, adresa elektronike e autorit korespondues. Nëse autorët janë prej institucioneve të ndryshme të përdoren fusnotat me numra arab.

Abstrakti – Duhet të ketë qëllimin, metodologjinë, rezultatet dhe konkluzat. Shkruhet në vetën e tretë njëjës, dhe deir në 250 fjalë.

Hyrja - duhet të ketë një prezantim të shkurtër dhe të qartë të problemit, si dhe duhet të shkruhet qëllimi i hulumtimit.

Materiali dhe metoda - duhet të përshkruhen procedurat e aplikuara, si dhe materiali i përdorur. Po ashtu, nëse punimi është në trajtë hulumtimi, duhet të përshkruhen procedurat statistikore të aplikuara në analizën e rezultateve.

Rezultatet - duhet të përshkruhen qartë dhe saktë.

Tabelat duhet të dërgohen veç e veç, në formatin MS Word. **Grafikonet** duhet të dërgohen veç e veç, në formatin MS EXCEL. **Fotografitë** duhet të dërgohen në dimensione minimale prej 15x10 cm, 300 DPI, në formatin JPEG ose TIFF.

Diskutimi - duhet të përshkruhen interpretimet e rezultateve dhe karahsimi i tyre me të dhënat e deritashme nga literatura.

Përfundimi - duhet të përshkruhen konkluzionet e arritura.

Literatura - Shkruhen në fund të punimit. Të gjitha referencat e cituara në tekstin e punimit duhet të radhiten me numra arab brenda kllapave të mesme, dhe të kenë të njëjtën radhitje në seksionin, sipas stilit Vancouver. Shembuj të citimit të literaturës:

Revistë

[1] Kamberi B, Hoxha V, Stavileci M, Dragusha E, Kuçi A, Kqiku L. Prevalence of apical periodontitis and endodontic treatment in a Kosovar adult population. BMC Oral Health 2011;11(1):32.

Libër /monografi

[2] Hoxha V. Sëmundjet e Dhëmbit-pjesa e parë. Botimi i dytë, Prishtinë: Armagedon; 2017.

Kapitull libri

[3] Begzati A, Berisha M, Mrasori Sh, Xhemajli-Latifi B, Prokshi R, Haliti F, Maxhuni V, Hysenaj-Hoxha V, Halimi V. Early Childhood Caries (ECC) - Etiology, clinical consequences and prevention. In: Mandeep V, editor. Emergency trends in oral health sciences and dentistry, 1st ed, London: InTech; 2015. [31-63].

Disertacion/magjistraturë

[4] Stavileci M. Analiza tredimensionale e morfologjisë së dhëmbit me mikrotomografi të kompjuterizuar para dhe pas përpunimit të kanalit të rrënjës [disertacion]. Prishtinë: Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Prishtinës; 2014.

Abstrakt nga libri / përmbledhja e konferencës

[5] Dula L, Shala K, Staka G, Pustina T, Bicaj T, Lila Z, Ahmedi E, Tmava A. Impact of removable partial dentures on masticatory efficiency and comparison with natural dentition. Book of abstracts of the 39th Annual Conference of the European Prosthodontic Association; 2015 September 3-5; Prague, Czech Republic; 2015. Abstract nr. 55.

Abstrakt online

[6] Meqa K, Dragidella F, Disha M, Sllamniku-Dalipi Z, Meqa M. Treatment of Periodontitis Using Photodynamic and Low-level Laser Therapy Int Dent J 2019; 69(Suppl. 1):58. eISSN: 1875-595X.(<https://onlinelibrary.wiley.com/doi/epdf/10.1111/idj.12520>)

Burim nga interneti

[7] FDI World Dental Federation. Letter from the President: Proud to stand up for optimal oral health in 2021. <https://www.fdiworlddental.org/>

Udhëzime etike

Të gjitha punimet duhet të jenë në përputhje me parimet e Deklaratës së Helsinkit (World Health Authority – 1975, edituar në vitin 2002). Në rast të prezantimit të rasteve klinike, nuk duhet shkruar emrat e pacientëve, inicialet ose të publikohet në tërësi fytyra e pacientit. Sa i përket plagjiaturës, punimet do të analizohen sipas udhëzimeve etike të publikimit.

Mirënjohjet dhe konflikti i mundshëm i interesit

Të gjitha burimet e financimit (private, publike, komerciale) veprat e dërguara në botimi, si dhe konfliktet e mundshme të interesit të autorit (marrëveshjet joformale me operatorët ekonomikë, kontratat për angazhime konsulente, mbajtjen e leksioneve të sponsorizuara në emër të prodhuesve, ose shitësve të materiali) duhet të publikohen në fund të tekstit.

Pronësia intelektuale mbi artikullin pas botimit, i mbetet botuesit-OSK-së për afat të pacaktuar.

Adresa e redaksisë për korespondencë

revista@osk-ks.org
<https://osk-ks.org/revista/>

Revista e Stomatologëve të Kosovës
Ulpiana, rr. Mark Dizdari (përballë Rrethit të Spitalit)
D 7, Hyrja II, nr. 6, 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +383 45 240 588

The *Journal of Dentists of Kosova* is published twice a year. Papers should be sent electronically to: revista@osk-ks.org

Category of papers:

- Scientific Research Publication
- Review Article
- Case Report
- Professional Review

We also welcome informative articles on specific issues of general interest in the dentistry sector, such as: short reports, summaries from scientific conferences, and editorial and similar reviews.

Preparation of the paper

The author of the paper and co-authors must guarantee by their signature on the form that the paper is original and has not been published in any other journal.

The paper must be written in Albanian, in Times New Roman, size 12.

The number of pages should not exceed 6 (six), including text and tables in Word, as well as photographs in JPEG format.

Scientific and professional papers should contain: cover letter, abstract, introduction, material with methodology, results, discussion, conclusions and literature. Other categories are formatted in different ways.

Cover letter - includes the title of the paper, the names of the authors, their qualifications, public/private institution, the corresponding author's email address. If the authors are from different institutions, use footnotes with Arabic numerals.

Abstract - Must have the purpose, methodology, results and conclusions. It is written in the third person singular, and up to 250 words.

Introduction - must have a brief and clear presentation of the problem, and the purpose of the research should be written.

Material and method - the procedures applied, as well as the material used, should be described. Also, if the paper is in the form of research, the statistical procedures applied in the analysis of the results should be described.

Results - must be described clearly and precisely.

Tables must be sent separately, in MS Word format. Graphs must be sent separately, in MS EXCEL format. Photographs must be sent in minimum dimensions of 15x10 cm, 300 DPI, in JPEG or TIFF format.

Discussion - interpretations of the results and their comparison with the existing data from the literature must be described.

Conclusion - the conclusions reached must be described.

Literature - They are written at the end of the paper. All references cited in the text of the paper must be listed with Arabic numerals within middle brackets, and have the same order in the section, according to the Vancouver style. Examples of literature citations:

Journal

[1] Kamberi B, Hoxha V, Stavileci M, Dragusha E, Kuçi A, Kqiku L. Prevalence of apical periodontitis and endodontic treatment in a Kosovar adult population. *BMC Oral Health* 2011;11(1):32.

Book/monograph

[2] Hoxha V. Dental Diseases-Part One. Second Edition, Prishtina: Armagedon; 2017.

Book Chapter

[3] Begzati A, Berisha M, Mrasori Sh, Xhemajli-Latifi B, Prokshi R, Haliti F, Maxhuni V, Hysenaj-Hoxha V, Halimi V. Early Childhood Caries (ECC) - Etiology, clinical consequences and prevention. In: Mandeep V, editor. *Emergency trends in oral health sciences and dentistry*, 1st ed, London: InTech; 2015. [31-63].

Dissertation/Master's degree

[4] Stavileci M. Three-dimensional analysis of tooth morphology with computed microtomography before and after root canal preparation [dissertation]. Prishtina: Faculty of Medicine, University of Prishtina; 2014.

Abstract from book/conference proceedings

[5] Dula L, Shala K, Staka G, Pustina T, Bicaj T, Lila Z, Ahmedi E, Tmava A. Impact of removable partial dentures on masticatory efficiency and comparison with natural dentition. Book of abstracts of the 39th Annual Conference of the European Prosthodontic Association; 2015 September 3-5; Prague, Czech Republic; 2015. Abstract no. 55.

Online abstract

[6] Meqa K, Dragidella F, Disha M, Sllamniku-Dalipi Z, Meqa M. Treatment of Periodontitis Using Photodynamic and Low-level Laser Therapy *Int Dent J* 2019; 69(Suppl. 1):58. eISSN: 1875-595X. (<https://onlinelibrary.wiley.com/doi/epdf/10.1111/ijdj.12520>)

Source from the Internet

[7] FDI World Dental Federation. Letter from the President: Proud to stand up for optimal oral health in 2021. <https://www.fdiworlddental.org/>

Ethical Guidelines

All papers must comply with the principles of the Declaration of Helsinki (World Health Authority – 1975, edited in 2002). In the case of presenting clinical cases, patients' names, initials or the patient's face in full should not be written. Regarding plagiarism, papers will be analyzed according to the ethical guidelines of the publication.

Acknowledgements and potential conflicts of interest

All sources of funding (private, public, commercial) of works submitted for publication, as well as possible conflicts of interest of the author (informal agreements with economic operators, contracts for consulting engagements, holding sponsored lectures on behalf of manufacturers or sellers of materials) must be published at the end of the text.

The intellectual property on the article after publication remains with the publisher-OSK for an indefinite period.

Editorial address for correspondence

revista@osk-ks.org
<https://osk-ks.org/revista/>

Journal of Dentists of Kosovo
Ulpiana, rr. Mark Dizdari (opposite the Hospital District)
D 7, Hyrja II, no. 6, 10000 Prishtina, Kosovo

Tel: +383 45 240 588

